

S
fi
pr

25
3
16

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË
K/ SEKRETARI

NR. _____ DATA 23/01/2019 Ora _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE LEZHE

Nr. 857 Prot.(E.Sh)

Lezhë, me 21 . 01 2019

Lënda: Dërgojmë kërkesën për vendosjen e sekuestros preventive.

Drejtuar.


GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
LEZHË

Bashkëlidhur me këtë shkresë po ju dërgojmë kërkesën për vendosjen e sekuestros preventive te procedimit penal nr. 57, viti 2019 rregjistruar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287 te K.Penal, si dhe aktet e procedimit penal nr. 57 viti 2019.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

Milan LASKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
LEZHE

KËRKESË

“PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE”

Në Lezhe, sot më date 22.01.2019, ora 12.00.

Une Erjon SHEHAJ, me detyrë Prokuror në Prokurorinë Prane Gjykeses se Shkalles se Pare Lezhe, pasi studjova aktet e procedimit penal nr. 57, të vitit 2019.

KONSTATOVA:

Prokuroria Prane Gjykeses se Shkalles se Pare Lezhe, mbi bazen e kallzimit penal te referuar nga Drejtoria Vendore e Policise Lezhe, me shkresen nr. 49/ prot, date 22.01.2019 me date 22.01.2019 ka rregjistruar proedimin penal nr. 57 viti 2019 per vepren penale te “Pastrimi i produkteve te vepres penale” te parashikuar nga neni 287 te K.Penal.

~~Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave~~, bazuar në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, nga verifikimet e kryera në databazin, për raportimet¹ e transaksioneve të vlerave, në emër të shtetasve Pjeter Nikoll Voci, i datëlindjes 01.07.1936 dhe Shqipe Pjetër Palaj, e dtl 28.08.1969 (e bija) dhe familjarët e tyre², rezultuan transaksione në vlera të konsiderueshme dhe me anomali si më poshtë:

Transaksione bankare

Për periudhën korrik 2018-janar 2019, rezultuan transaksione në vlera domethënëse kryesisht në “Banka Kombëtare Tregtare” në emër të ketyre dy shtetasve.

Raportime të tjera në emër të:

Në bazë të Ligjit nr.9917 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" datë 19.05.2008, i ndryshuar neni 12/pika 3 Subjekteve u kërkohet t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1.000.000 Lek, ose kundërvlerën në monedhë të huaj, të kryer si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve.

Adelina Pjeter Voci (dtl:01.10.1974), Simon Voci (dtl: 23.06.1965), Paulin Palaj (dtl: 15.05.1968), Geraldo Voci (dtl: 11.04.1995), Gidian Paulin Palaj (dtl:01.10.1993), Alesja Paulin Palaj (dtl:12.09.1998).

u

Shqipe Palaj

Kontrata noteriale

Më datë 14.09.2018, Shqipe Palaj ka porositur blerjen e tre apartamenteve dhe 3 post parkimeve në Tiranë, nga Flamur Hoxha me NUIS: L41923001G në vlerën e deklaruar prej 729 005 EUR, (vlera e apartamenteve 675 000 EUR dhe 54 000 EUR ajo e post-parkimeve.)

Transaksione bankare

Paulin Palaj

Transaksione bankare

Më datë 09.08.2013, llogaria në "Raiffeisen Bank" i është debituar në shumën prej 37 000 EUR.

Më datë 11.09.2013, llogaria në "Raiffeisen Bank" i është debituar në shumën prej 10 000 EUR.

Simon Voci

Kontrata noteriale

Më datë 17.07.2015, ka blerë³ nga shoqëria "EURO ADRIATIC" apartamentin në vlerën e deklaruar prej 30 000 EUR.

Më datë 22.06.2018 ka blerë⁴ një apartment nga Arian Pitamina i dtl 20.06.1982, në vlerën e deklaruar prej 5 040 000 LEK.

Adelina Voci

Kontrata noteriale

Më datë 02.08.2013, ka nënshkruar një prokurë të posaçme te noteri Vasil Martini, ku emëron përfaqësues të posaçëm për nënshkrimin e kontratës së shitjes së një apartamenti, shtetasin Paulin Palaj.

Më datë 10.08.2013, ka blerë një pasuri të paluajtshme në vlerën 6 000 000 LEK, te noter Vasil Martini.

Më datë 14.08.2018, ka blerë një apartament nga shtetasi Edi Paloka i dtl 23.12.1965, në vlerën e deklaruar prej 8 750 000 LEK. Është bërë kalimi me bankë si më poshtë.

Më datë 21.08.2014, ka nënshkruar një prokurë të posaçme te noteri Ervis Klari.

Më datë 18.08.2016, së bashku me Simon Voci ka nënshkruar një prokurë të posaçme te noteri Vasil Martini ku është parashikuar se Pjeter Voci do të përfaqësojë këta dy shtetas në nënshkrimin e kontratës së pjesëtimit të pasurive të paluajtshme të përfituar me ligjin nr.7501 si dhe nga trashëgimia e Prenë Vocin.

³A. n me nr. Rep/Kol, 2487/1915 nënshkruar te noter Vasil Martini.

⁴A. n me nr. Rep/kol 2082/1467, nënshkruar te noter Vasil Martini.

u

Shqipe Palaj

Kontrata noteriale

Më datë 14.09.2018, Shqipe Palaj ka porositur blerjen e tre apartamenteve dhe 3 post parkimeve në Tiranë, nga Flamur Hoxha me NUIS: L41923001G në vlerën e deklaruar prej 729 005 EUR, (vlera e apartamenteve 675 000 EUR dhe 54 000 EUR ajo e post-parkimeve.)

Transaksione bankare

Paulin Palaj

Transaksione bankare

Më datë 09.08.2013, llogaria në “Raiffeisen Bank” i është debituar në shumën prej 37 000 EUR.

Më datë 11.09.2013, llogaria në “Raiffeisen Bank” i është debituar në shumën prej 10 000 EUR.

Simon Voci

Kontrata noteriale

Më datë 17.07.2015, ka blerë³ nga shoqëria “EURO ADRIATIC” apartamentin në vlerën e deklaruar prej 30 000 EUR.

Më datë 22.06.2018 ka blerë⁴ një apartment nga Arian Pitamina i dtl 20.06.1982, në vlerën e deklaruar prej 5 040 000 LEK.

Adelina Voci

Kontrata noteriale

Më datë 02.08.2013, ka nënshkruar një prokurë të posaçme te noteri Vasil Martini, ku emëron përfaqësues të posaçëm për nënshkrimin e kontratës së shitjes së një apartamenti, shtetasin Paulin Palaj.

Më datë 10.08.2013, ka blerë një pasuri të paluajtshme në vlerën 6 000 000 LEK, te noter Vasil Martini.

Më datë 14.08.2018, ka blerë një apartament nga shtetasi Edi Paloka i dtl 23.12.1965, në vlerën e deklaruar prej 8 750 000 LEK. Është bërë kalimi me bankë si më poshtë.

Më datë 21.08.2014, ka nënshkruar një prokurë të posaçme te noteri Ervis Klari.

Më datë 18.08.2016, së bashku me Simon Voci ka nënshkruar një prokurë të posaçme te noteri Vasil Martini ku është parashikuar se Pjeter Voci do të përfaqësojë këta dy shtetas në nënshkrimin e kontratës së pjesëtimit të pasurive të paluajtshme të përfutur me ligjin nr.7501 si dhe nga trashëgimia e Prenë Vocin.

A n me nr. Rep/Kol, 2487/1915 nënshkruar te noter Vasil Martini.
A n me nr. Rep/kol 2082/1467, nënshkruar te noter Vasil Martini.

6

Më datë 20.10.2016, ka blerë 5 një pasuri të paluajtshme "apartament" në vlerën e deklaruar prej 34 000 EUR nga shtetasit Sadete dhe Sabit Mustafa të dtl 26.12.1958 dhe 30.06.1954.

Më datë 14.08.2018, ka blerë 6 një apartament në vlerën e deklaruar 70 000 EUR, nga shtetasi Edi Paloka, i dtl 23.12.1965.

Më datë 14.09.2018, ka blerë nga shtetasit Dalip dhe Kimete Mata të dtl 20.04.1965 dhe 13.02.1968, një apartament në Shëngjin në vlerën e deklaruar prej 80 000 EUR.

Sa më sipër, bazuar në nenin 11/e⁷ të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, i ndryshuar kemi kërkuar informacion në "Banka Kombëtare Tregtare" lidhur me këta shtetas, nga ku ka rezultuar se:

Për periudhën 23.07.2018 e në vijim llogaria e Shqipe Palaj në "Banka Kombëtare Tregtare" është kredituar nga 10 transfertat të dërguara nga Zvicra, nga një shtetas suedez me gjeneralitete Sten Ake Lindholm në vlerën totale prej 1 419 626 EUR përshkruar si më poshtë:

Për periudhën 23.07.2018-29.08.2018 kanë mbërritur 5 transfertat në vlerën totale prej 1 184 838 EUR ku vetëm transfertat e parë përmbante qëllimin e dërgimit, atë të deklaruar si "shpenzime familjare" në vlerën prej 9 978 EUR, ndërkohë të tjerat nuk përmbanin asnjë element për përshkrimin e qëllimit të përdorimit të shumave të dërguara. Në BKT kjo shtetase ka bërë disa deklarata kontradiktore si:

Fondet në të vërtetë janë dhuruar nga shtetasi suedez me vendbanim në Zvicër, për shkak të marrëdhënieve të afërta të motrës së saj, Adelina Voci, shtetase suedeze, me shtetasin suedez Sten Ake Lindholm, i cili është pronar i kompanisë "BILTEMA", (me aktivitet tregtimin me shumicë dhe pakicë të pjesëve të këmbimit dhe aksesoreve të makinerive dhe mjeteve motorike) në të cilën shtetasja Adelina Voci, punon si menaxhere, me qëllimin e përdorimit të tyre për blerjen e 3 apartamenteve nga dy motrat dhe vëllai i tyre shtetasit Simon Voci.

Fondet në fakt destinohen si dhuratë për motrën e saj Adelina Voci, e cila do t'i investojë në blerjen e pasurive të paluajtshme në Shëngjin.

Konkretisht në këtë periudhë evidentohet se:

Më datë 30.07.2018, llogaria i është kredituar në shumën 9 978 EUR nga transfertat e shtetasit suedez Sten Ake Lindholm me përshkrim "shpenzime spitalore". Më datë 31.07.2018 ka tërhequr në cash 9 975 EUR, ndërkohë lidhur me përdorimin e pjesës tjetër të fondeve të transferuara rezulton që:

⁷ An me nr. Rep/Kol, 4896/3419 nënshkruar te noter Vasil Martini.

⁸ An me nr. Rep/Kol, 2735/1894, nënshkruar te noter Vasil Martini.

Sipas neni 11/e të Ligjit 9917, subjektet kanë detyrim të paraqesin informacion, të dhëna dhe dokumente shtesë, autoritetit përgjegjës, në përputhje me kërkesat dhe afatet kohore për rastet e parashikuara në këtë ligj.

Më date 01.08.2018, llogaria i është kredituar nga transfertat tjetër e shtetasit suedez Sten Ake Lindholm në vlerën prej 24 950 EUR. Nga kjo shumë vlere prej 20 000 EUR ka kaluar në favor të noterit, Vasil Martini pranë "Tirana Bank" dhe më vonë më datë 02.08.2018 ka tërhequr 4 800 EUR.

Më datë 15.08.2018 & 29.08.2018, llogaria i është kredituar edhe nga dy transfertat të tjera, përkatësisht në vlerat 49 925 EUR & 29 945 EUR. Më datë 03.09.2018, këto fonde i ka kaluar në favor të noterit Vasil Martini.

Duhet theksuar se për të dy pagesat në favor të noterit Vasil Martini, Shqipe Pjeter Palaj ka deklaruar verbalisht se qëllimi i tyre do të ishte për "Blerje Apartamenti për Adelina Voci" dhe "Likuidim, blerje pasurie e paluajtshme".

Më datë 30.08.2018, llogaria e saj është kredituar në shumën prej 1 069 925 EUR, e cila ka pasur vlerën më të konsiderueshme në raport me transfertat e mëparshme, përkatësisht pa asnjë detaj në rubrikën e "përshkrimi i transaksionit", prej të cilave 469 638 EUR janë vendosur në depozitë, 79 800 janë transferuar në favor të noterit Vasil Martini dhe 600 000 EUR janë transferuar në favor të Flamur Hoxha-PF.

Për periudhën nëntor 2018-janar 2019, llogaria e saj është kredituar në shumën totale prej 234 788 EUR nën përshkrimet:

"dhuratë për Krishtlindje, kompensim page, veshmbathje dimri, aksesore kuzhine" (49 900 EUR), *"rikonstruktim dhe ndihmë financiare"* (94 875 EUR) *"mbulimin e disa shpenzimeve spitalore për kurimin e të atit të saj"* (4 983 EUR), *"blerje pajisjesh shtëpiake"* (84 925 EUR). Nga kjo shumë totale, 94 900 janë vendosur në depozitë, 4 983 EUR janë tërhequr.

Më datë 16.01.2019, Pjeter Voci ka çelur një llogari pranë BKT, arsye e hapjes së cilës e ka deklaruar për qëllimin e përfitimit të disa fondeve nga shtetasi suedez Sten Ake Lindholm, të cilat do të përdoren për mbulimin e disa shpenzimeve spitalore të Pjeter Voci i dekaltron se vuan nga një sëmundje veshkash.

Më datë 17.01.2018, ka mbërritur një transfertë nga Zvicra, në vlerë tepër të konsiderueshme 3 849 925 EUR. Urdhëruesi i kësaj transferte është Sten Ake Lindholm dhe përvoja i përket qëllimit të saj, nga detajet e pagesës kuptojmë se bëhet fjalë për një dhuratë *"Gift to my dearest friend Pjeter Voci"*. Banka urdhëruese e transfertës është "BANQUE CANTONALE DU VALAIS" në Zvicër dhe banka korespondente është COMMERZBANK AG në Gjermani.

Të dhenat identifikuese të transfertës në mbërritje janë si mëposhtë:

COBADEFFXXX = COMMERZBANK AG

20: FAAE901702974800

23B: CRED

32A: 190117EUR3849925,00

33B: EUR3850000,00

50K: /CH4600765001030433310

50K: STEN AKE LINDHOLM

50K: ROUTE DES ZIRES 19

50K: 3963 CRANS-MONTANA CH

52A: 52A:BCVSCH2L

52A: BCVSCH2LXXX = BANQUE CANTONALE DU VALAIS

59: /AL5220554185004561CLIDCFEURV

59: PJETER NIKOLL VOCI

59: LAGJIA SKENDERBEG

59: 4501 LEZHE

70: GIFT TO MY DEAREST FRIEND PJETER VOCI

Lidhur me përfitimin e fondeve të konsideruara në emër të Shqipe Palaj kemi kërkuar informacion pranë homologëve suedezë dhe zvicerane, prej të cilave jemi informuar vetëm nga homologët suedezë që shtetasi Sten Ake Lindholm ka biznese por nuk kanë më shumë të dhëna pasi transaksionet nuk kryen nëpërmes Suedisë. Nga homologët zvicerane nuk kemi marrë përgjigje. Duke parë zhvillimet e rastit kemi kërkuar informacion të dytë pranë homologëve zvicerane dhe jemi në pritje.

Nga sa më sipër duke marrë në konsideratë:

1. Vlerën e konsiderueshme të transfertave në mbërritje të pa-justifikuara,
2. Mungesën e detajeve mbi qëllimin e transferimit të këtyre fondeve si dhe mospërputhjen që ekziston ndërmjet informacioneve të dhëna në lidhje me arsyen e përfitimit të këtyre fondeve dhe përshkrimit të përcaktuar në mesazhin e Sëifit të transfertës së parë të mbërritur në llogarinë e Shqipe Palaj "shpenzime spitalore".
3. Mundësitë reale të përdorimit të fondeve të mbërritura në llogari të Pjeter Vocit sikurse është deklaruar, për mbulimin e shpenzimeve spitalore (të cilat janë tepër të larta për çdo vend

30

tjetër, përveçse në Shqipëri, shtuar këtu dhe moshën e Pjeter Vocit, 83 vjeç, moshë e cila teorikisht është tepër e vështirë të përballojë ndërhyrje të tilla);

4. Mundësinë që qëllimet reale të shtetasve;
5. Tjetërsimi i fondeve dhe investimi në pasuri të paluajtshme në Shqipëri për llogari të personave të tretë (*jo-rezident*) (*është e paqartë pse Lindholm i transferon nga llogaria e tij personale tek llogaria e Shqipe Palaj në Shqipëri.*)
6. Maskimi i fondeve, duke bërë të mundur që përfituesi final të mos jetë Shqipe Palaj dhe të afërmit e saj, por vetë dërguesi i këtyre fondeve Sten Ake Lindholm.
7. Numrin e lartë të transfertave të kryera brenda një periudhe të shkurtër kohe;
8. Mungesën e një dokumentacioni që justifikon deklaratimet e Shqipe Palaj në lidhje me pozicionin e lartë menaxherial të motrës së saj Adelina Voci në kompaninë "BILTEMA", *lindin dyshime se kemi të bëjme me një skemë për të kryer pastrim të produkteve të veprës penale, dyshime mbi burimin e fondeve dhe aktivitetin e kryer, e për rrjedhojë Drejtoria e Pergjithshme të pastrimit të parave ka nejerre Urdherin Nr 1765/21 date 21.01.2019 urdhër bllokimi me efekt 72 orë nga marrja dijeni për Bankën Kombëtare Tregtare, për llogaritë/transaksionet bankare në emër dhe për llogari të Pjetër Nikoll Voci i datëlindjes 01.07.1936 dhe Shqipe Pjetër Palaj e dtl 28.08.1969, të cilat i gjeni bashkëlidhur. Vlera totale e bllokuar nga D.P.P.P.P është: 5 269 551 EUR.*

Sa më sipër, duke qenë se shtetasit Pjeter Nikoll Voci dhe Shqipe Pjeter Palaj kane kryer veprimtari kriminale ne kundërshtim me ligjin dhe vendosja e sekuestros mbi kete shume parash eshte e domosdoshme deri ne sqarimin e rrethanave te plota ne lidhje me kete procedim penal, në mbështetje te neneve 274 te K. Pr Penale;

KËRKOJ:

- I- Vendosjen e sekuestros preventive për llogarit, transaksionet bankare dhe çdo depatim në emër dhe për llogari të shtetasve të poshtëshënuar.
 - Pjeter Voci, i biri i Nikolle dhe Dile, i datëlindjes 01.07.1936, me ID nr. D60701021L, lindur ne fshatin Kalivaç, banues ne fshatin Gjader, Njesia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe.
 - Shqipe Palaj, e bija e Pjetër dhe Prende, e datelindjes 28.08.1969, me ID nr.G95828055L, lindur ne fshatin Gjader dhe banues ne Lezhe .

9

- 2- Mbi pasuritë e paluajtshme duke urdheruar sekuestrimin e tyre ne Zyren Vendore te Regjistrimit te pasurive te Paluajtshme Lezhe, ashtu dhe ne gjendjen faktike ne te cilen ndodhen sot në pronësi të shtetasve te poshtëshënuar.
- **Pjeter Voci**, i biri i Nikolle dhe Dile, i datëlindjes 01.07.1936 lindur ne fshatin Kalivaç, banues ne fshatin Gjader, Njesia Administrative Balldre, Bashkia Lezhe.
 - **Shqipe Palaj**, e bija e Pjetër dhe Prende, e datelindjes 28.08.1969 lindur ne fshatin Gjader dhe banues ne Lezhe.

PROKURORI
Erjon SHEHAJ

